Kronikë

# Breshëri plumbash drejt një mobilierie në Nikël gjatë mesnatës, autori dhe shkaqet enigmë! Pronari: S'kam borxhe, as probleme me njeri

*Një mobilieri është qëlluar me breshëri plumbash mesnatës e djeshme në fshatin Nikel të Krujës.*

Redaksia
15 Prill, 09:53 | Përditesimi i fundit: 15 Prill, 11:26

**LEZHË-** Një mobilieri është qëlluar me breshëri plumbash mesnatës e djeshme në fshatin Nikel të Krujës. Persona ende të paidentifikuar kanë qëlluar me automatik në drejtim të mobilierisë në pronësi të Myslym Karait. Ka qenë pikërisht pronari ai që ka njoftuar policinë, pasi ka gjetur gëzhoja në fasadë mëngjesin e sotëm, 20 plumba kallashnikovi kanë goditur mobilierin.

Jashtë kamerave pronari deklaroi se nuk ka asnjë qindarkë borxh njeriu dhe se as ai dhe as familja e tij nuk kanë ngacmuar asnjë njeri në jetë.  Karai ka rreth 20 vite që ushtron këtë aktivitet dhe në zonë familja e tij njihet si ndër më të qetat.


LEXO EDHE:
**E kishin kthyer magazinën në 'shtëpi bari', në pranga 2 persona në Krujë, në kërkim 3 të tjerë! Sekuestrohen 700 bimë kanabisi! Në pranga edhe 2 elektricistë të OSHEE**

Ndërsa është e pajisur me kamera sigurie, të cilat janë sekuestruar nga policia. Mësohet se roja i objektit ndodhej në pjesën e pasme të ndërtesës, aty ku edhe bëhet prodhimi i mobilieve.

Policia ka sekuestruar edhe kamerat e të gjithë zonës me qëllim zbulimin e sa më shumë informacioneve për incidentin.

J.GJ./K.T./Shqiptarja.com

TAG: myslym karai | mobilieri | krujë

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
A duhet që SPAK të hetojë të shpallurit non grata nga SHBA-të?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë

Konflikti për apartamentet në 15-katëshin e Krujës, 24 familje në protestë: Pronari shiti shtëpitë 2 herë
30 Mars, 19:00

Kronikë

Përfshihet nga flakët një sipërfaqe e madhe pyjesh në Krujë
29 Mars, 18:22

Kronikë

U kapën me 2 'shtëpi bari' , sekuestrohen 17.1 kg kanabis, në pranga 2 persona, në kërkim 1 tjetër në Krujë
25 Mars, 10:08

Kultura

Mbyllet Muzeu Etnografik në Krujë, do të jetë i vizitueshëm për publikun për një periudhë 8-mujore
23 Mars, 16:55

Kronikë

Krujë, digjet pylli në Dollakë, ndërhyrja e zjarrfikësve e pamundur për shkak të terrenit të thyer! Zjarri vijon prej disa orësh
22 Mars, 17:54

Kronikë

Zjarr në pyllin me pisha në Krastë të Krujës, flakët favorizohen nga era, terreni i thyer vështirëson ndërhyrjen e zjarrfikëses
20 Mars, 11:16

Kronikë

Përplasen dy makina në Fushë-Krujë, 5 viktima! Festa e fejesës kthehet në tragjedi, humbin jetën çifti i të rinjve dhe 3 persona të tjerë
6 Mars, 08:30

Sociale

Kruja zgjohet nën temperaturat e ulëta dhe erën e fortë, petku i bardhë mbulon qytetin turistik
1 Mars, 09:16

Kultura

Pas 2 dekadash rikthehet jeta kulturore në Krujë (VIDEO)
12 Shkurt, 14:36

Kronikë

Digjet mobilieria në Nikël, video nga zjarri! 3 zjarrfikëse në 'luftë' me flakët, era e fortë rrezikon edhe magazinat ngjitur
8 Shkurt, 19:35

Sociale

AKM gjobit një tjetër kryetar bashkie për mosmenaxhim të mbetjeve, ndëshkohet me 500 mijë lekë gjobë kryebashkiaku i Krujës, Artur Bushi
8 Shkurt, 15:39

Politikë

Integrimi në BE/ Rama 'thumba' Sorecës: Vetëm në Napoli s'ka burokraci, mund të bëhemi dhe ne si ta dhe Brukseli të vazhdojë punën e vet
8 Shkurt, 11:25




RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje